



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 53
Prishtinë, më 28.1.2019, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Fidan Rekalju, Arbërie Nagavci, Driton Çausi, Abdyl Salihu dhe Albulena Balaj-Halimaj.

Munguan: Verica Çeraniç dhe Nezir Çoçaj.

Përfaqësues të tjerë: përfaqësues të KDI-së dhe mediave.

Stafi mbështetës i komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 17.12.2018 dhe 15.1.2019;**
- 3. Miratimi i raportit të punës së komisionit për vitin 2018;**
- 4. Shqyrtimi i Planit të punës së komisionit për vitin 2019;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me propozimin për ndryshimin e renditjes së shqyrtimit të pikave 3 dhe 4 të rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 17.12.2018 dhe 15.1.2019

Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 17.12.2018 dhe 15.1.2019, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Planit të punës së komisionit për vitin 2019

Ismajl Kurteshi tha se draft- plani i punës për vitin 2019 është hartuar bazuar në programin legjislativ për vitin 2019. Sipas këtij programi komisionit gjatë këtij viti është i ngarkuar për shqyrtim të 8 projektligjeve, prej të cilave 4 nga MASHT, 3 nga MKRS dhe 1 nga Ministria e Inovacionit. Sipas programit legjislativ shumica nga këto projektligje parashihen të procedohen në Kuvend gjatë sesionit vjeshtor, kështu që është pamundur të miratohen gjatë këtij viti. Aktivitet tjetër i paraparë në Planin e punës së komisionit është edhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve, ku edhe kërkohet vazhdimi dhe përfundimi i mbikëqyrjes së dy ligjeve të cilat janë në proces.

Arbërie Nagavci, propozoi që në planin e punës për vitin 2019, në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve të bëhet mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, duke pasur parasysh se cilësia në arsim është e dobët dhe ka probleme në zbatimin tij. Me këtë rast kërkoi që të caktohet grupi punues dhe kryesuesi i tij, si dhe krahas planifikimeve për mbikëqyrje të përcaktohet edhe afati kohor për përfundimin e tij.

Teuta Haxhiu, në diskutimin e saj, tha se duhet të vazhdohet me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve të cilat janë në proces nga viti i kaluar, gjithashtu pajtohet me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, si dhe propozon të bëhet mbikëqyrja e Ligjit për Arsimin e Lartë duke pasur parasysh shkeljet e mëdha që po ndodhin në arsimin e lartë.

Fidan Rekalju tha se duhet t'i kushtohet rëndësi edhe Ligjit për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë i cili është në proces të hartimit të tij dhe të kërkohet që të procedohet në Kuvend për miratim.

Albulena Balaj- Halimaj tha se meqenëse projektligji për Arsimin e Lartë është në procedurë të shqyrtimit në Kuvend, nuk e sheh të arsyeshme që të fillohet me mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji në këtë fazë. Propozoi që të përfundohet mbikëqyrja e zbatimit të dy ligjeve të filluara më parë dhe më pastaj të fillohet me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Arsimin Parauniversitar.

Valentina Bunjaku -Rexhepi, në diskutimin e saj, tha se komisioni duhet të vazhdojë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve të filluara vitin e kaluar dhe pastaj të shikohet mundësia e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve të tjera.

Driton Çausi tha se pajtohet që në planin e punës për vitin 2019 të përfshihet mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Arsimin Parauniversitar dhe njëkohësisht shpreh gatishmërinë për të qenë pjesë e grupit punues për monitorim.

Ismajl Kurteshi tha se nga diskutimet e anëtarëve të Komisionit shihet se ka vullnet për vazhdimin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve që janë në proces nga viti i kaluar, si dhe përfshirjen e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Arsimin Parauniversitar. Meqenëse ndërkohë struktura e komisionit ka pësuar ndryshime, propozoi që në një nga mbledhjet e radhës të formohen grupet punuese për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve.

Arbërie Nagavci, propozoi që të kërkohet nga MASHT-i që Projektligjin për tekstet dhe mjeteve shkollore, lekturë shkollore dhe dokumentacionin pedagogjik në Republikën e Kosovës dhe Projektligjin për Edukimin Parashkollor – Edukimin në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç në Republikën e Kosovës, t'i procedojë sa më shpejt në Kuvend.

Komisioni u pajtua që t'i drejtohet MASHT-it me kërkesën që Projektligjin për tekstet dhe mjeteve shkollore, lekturë shkollore dhe dokumentacionin pedagogjik në Republikën e Kosovës dhe Projektligjin për Edukimin Parashkollor – Edukimin në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç në Republikën e Kosovës, t'i procedoni gjatë sesionit pranveror në Kuvend.

Pas diskutimeve anëtarët e komisionit unanimisht miratuan Planin e Punës së komisionit për vitin 2019.

4. Miratimi i raportit të punës së komisionit për vitin 2018

Ismajl Kurteshi tha se raporti i punës së komisionit për vitin 2018 pasqyron punën dhe aktivitetet e realizuara. Ai tha se sipas analizave të tija komisioni gjatë vitit 2018 nuk ka realizuara mjaftueshëm vizita në shkolla, e sidomos në zonat rurale, ka bashkëpunuar suksesshëm me disa institucione, e sidomos duhet veçuar bashkëpunimin me GIZ gjatë shqyrtimit të projektligjit për Inspektoratit e Arsimit dhe ekspertiza të ndryshme për çka i falënderojë, kemi realizuar dy vizita jashtë vendit në Shqipëri, ku kemi realizuar takime në ministri dhe inspektorat, si dhe një vizitë në Bruksel.

Si sfida të cilat duhet veçuar gjatë punës së komisionit janë mungesat e shumta të disa anëtarëve në mbledhjet e komisionit, sipas evidencës janë mbajtur gjithsejtë 50 mbledhje, mungesat e anëtarëve të komisionit janë nga 1 mbledhje deri në 30 mbledhje.

Çështje tjetër përmendi mosrespektimin e rregullores së punës gjatë mbledhjeve nga anëtarë të caktuar, me këtë rast përmendi rastet e ndërhyrjes në diskutime, akuza dhe ofendime ndaj anëtarëve, diskutime të gjata dhe jashtë rendit të ditës, si dhe marrja e fjalës pa lejen e kryesuesit. Me këtë rast, me qëllim të mbarëvajtjes së punës së komisionit kërkoi nga anëtarët që në të ardhmen të respektohet rregullorja duke iu përmbajtur rendit të ditës, për një çështje të kërkohet fjala një herë, të mos zgjasin diskutimet më tepër se 10 minuta dhe gjatë diskutimeve të mos ofendohen anëtarët e tjerë. Ai tha se ndaj anëtarëve të komisionit që nuk iu përmbahen këtyre rregullave fillimisht do t'iu tërhiqet vërejtja, do të kërkohet nga ta që ta lëshojnë mbledhjen, në të kundërtën do të jetë i detyruar ta ndërpresë mbledhjen dhe të dërgojë shkresë grupeve parlamentare dhe kryesisë për zëvendësimin e anëtarëve.

Valentina Bunjaku- Rexhepi, në diskutimin e saj, tha se pajtohet me diskutimin e kryesuesit dhe tha se në disa raste ka pasur situata ku ka qenë e pamundur të japim kontributin tonë për çështje

të caktuara si rezultat i ndërhyrjeve, jo të arsyeshme gjatë diskutimeve. Ajo tha se në komision jemi të gjithë të barabartë dhe jemi këtu për të dhënë kontributin tonë pa dallim të përkatësisë partiake në të mirë të vendit tonë, në vazhdim tha se duhet të krijohen kushte normale për punë pa ndërhyrje, në të kundërtën nëse vazhdohet kështu me ndërhyrje do të jemi të detyruar si anëtarë të komisionit nga grupi parlamentar i LDK-së ta bojkotojmë punën e këtij komisioni.

Arbërie Nagavci tha se mbështet propozimet e parafolësve dhe konsideron se është detyrë e secilit prej nesh dhe në radhë të parë e kryesuesit të krijohen kushtet për punë me qëllim që të kontribuojmë për çështjet që na presin në radhë të parë për përmirësimin e cilësisë në arsim dhe në trajtimin e çështjeve të tjera nga ministritë e linjës, si dhe çështjeve të shumta që na presin. Lidhur me këtë tha se nevojitet së paku krijimi i kushteve për adresimin e çështjeve dhe zgjidhjen e tyre.

Ajo tha se ndërhyrjet kanë qenë shpesh të qëllimshme në mënyrë që të mos diskutohet për probleme të vërteta ku në mbledhjen e fundit humbi edhe qëllimi për çka është dashur të diskutohen për shkak të ndërhyrjeve të shumta dhe adresimit të çështjeve të tjera.

Ajo tha se është obligim i secilit prej nesh që të krijojnë kushtet për punë duke respektuar rregulloren në mënyrë që të japim kontributin tonë për të cilin jemi zgjedhur.

Me këtë rast kërkoi që anëtarëve të komisionit së bashku me procesverbalin t'i dërgohet një kopje të rregullores.

Abdyl Salihu tha se gjatë vitit të kaluar kemi bërë bashkërisht një punë të konsiderueshme duke përmbushur detyrat që i kemi pasur, njëkohësisht shpreson në bashkëpunimin e anëtarëve të komisionit në përmbushjen e planit të punës për vitin 2019 gjithnjë duke respektuar rregulloren e punës.

Ismajl Kurteshi tha se rregullorja na obligon të gjithëve dhe të njëjtën duhet respektuar dhe se disa nga lëshimet janë bërë edhe për shkak të kolegjalitetit.

Pas diskutimeve, anëtarët e komisionit unanimitisht miratuan raportin e punës për vitin 2018.

5. Të ndryshme

Arbërie Nagavci, ngriti çështjen e mungesës së përgjigjeve nga ana e MASHT lidhur me pyetjet me shkrim të cilat ia kemi dërguar, e që kanë të bëjnë me punësimet në inspektoratin e Arsimit, qendrat me bazë në komunitet, mësimdhënësit e Fushë- Kosovës që kanë mbetur jashtë listës së pagave dhe disa rate të tjera për të cilat nuk kemi marrë përgjigje.

Ismajl Kurteshi tha se duhet shikuar në cilat shkresa është përgjigjur MASHT-i dhe për rastet të cilat nuk kemi marrë përgjigje duhet kërkuar llogari.

Mbledhja përfundoi në orën 14:50.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit

Kryetari i komisionit,

Ismajl Kurteshi